



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 26 Prill 2021

Nr: 212

URDHËR

PËR

**DISIPLINIMIN DHE VAZHDIMIN NË MËNYRË TË PANDËRPRERË TË PROCESIT TË
NUMËRIMIT TË TË GJITHA KUTIVE TË VOTIMIT TË PRANUARA TË RREGULLTA
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “b”, e 2, 32, pikat 1, shkronja “a”, e 3, 95, 119, pika 5, 168 dhe 171, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 11, të vendimit nr. 14 datë 10.04.2021, të Komisionit Rregullator, “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votive, rradhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votive dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Komisionet e Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve (KZAZ-të) dhe Grupet e Numërimit të Votave (GNV-të) të vijojnë procesin e numërimit të kutive të votimit, të pranuar si të rregullta nga KZAZ-të, në mënyrë të pandërprerë.
2. KZAZ-të, me qëllim garantimin e vazhdimin të pandërprerë të procesit të numërimit, duhet të organizojnë me grafik shpërndarjen e punës midis grupeve të para dhe të dyta të numërimit, sipas përcaktimeve të pikës 4 të nenit 95 të Kodit Zgjedhor .
3. Anëtarët e GNV-ve të cilët nuk zbatojnë rradhën e paraqitjes në detyrë sipas grafikut zëvendësohen menjëherë nga partia politike e cila ka propozuar anëtarin. Partia politike e paraqet menjëherë propozimin e ri.
4. Nëse partia politike përkatëse nuk paraqet propozimin për plotësimin e vendit të mbetur vakant, brenda 1 ore nga momenti i marrjes së vendimit, KZAZ njofton KQZ-në dhe përcjell menjëherë material kallëzues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor përkatës për anëtarin që ka braktisur detyrën.



Data: 26 Prill 2021

Nr. 212

“Për disiplinimin dhe vazhdimin në mënyrë të pandërprerë të procesit të numërimit të të gjitha kutive të votimit të pranuar të rregullta për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”

5. Veprimet apo mosveprimet e anëtarëve/sekretarit të KZAZ-ve dhe të anëtarëve të GNV-ve, përfshirë ngadalësimin e procesit të numërimit, konsiderohen shkelje e pikës 5, të nenit 119 të Kodit Zgjedhor, dhe përbëjnë shpërdorim detyre në përputhje me nenin 248 të Kodit Penal dhe materiali kallëzues dërgohet menjëherë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor përkatës. KQZ-ja kryesisht, shkarkon anëtarin/ sekretarin e KZAZ-së.
6. KZAZ-të të njoftojnë menjëherë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për çdo parregullsi dhe problematikë që shfaqet, si dhe të përditësojnë informacionin pranë KQZ-së për dinamikën e zhvillimit të procesit.
7. Ngarkohen KZAZ-të dhe GNV-të për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





Data: 26 Prill 2021
Nr. 212

“Për disiplinimin dhe vazhdimin në mënyrë të pandërprerë të procesit të numërimit të të gjitha kutive të votimit të pranuar të rregullta për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”